

VENDIM
Nr. 702, datë 13.11.2024

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 77, DATË 28.1.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME
DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SIGURIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 10, 11, 13, 15 e 99, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 6, 8 e 9, të ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “j”, të pikës 1, të kreut I, shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) Nxënësit punëmarrës, që ndjekin arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe që nënshkruajnë një kontratë pune për mësimin e profesionit, me pagesë mujore, për të cilët paguhen kontribute nga punëdhënësi në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për kohëzgjatjen e kontratës.”.

2. Pas pikës 22, të kreut III, shtohet pika 23, me këtë përmbajtje:

“23. Për nxënësin punëmarrës, që ndjek arsimin dhe formimin profesional, në formën e dyfishtë në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, që nënshkruan një kontratë pune për mësimin e profesionit me pagesë, kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundjet profesionale është në vlerën 0.3% të pagës bruto minimale në shkallë vendi dhe përballohet nga kompania trajnuese për arsimin e dyfishtë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama